

KONTRATË BINJAKËZIMI
Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIONIN

Një Sistem Cilësie për Statistikat:

Activity 1.2.1.3: Vazhdim i përkrahjes në punën rreth cilësisë në ASK

Komponenti 1

Misioni i realizuar nga Lars Thygesen dhe Hilikka Vihavainen

2-6 Nëntor 2015

IPA 2012

Emri, adresa dhe emaili i autorit

*Lars Thygesen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +4554627664
Mob: +4528403941
Email: lthygesen@gmail.com*

*Hilkka Vihavainen
Statistics Finland
Verkstadsgatan 13
FI-00022 Helsinki
Finland
Tel: +358 50 5002296
Email: hilkkal.vihavainen@gmail.com*

Përmbajtja

RAPORTI MBI MISIONIN.....	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Lista e shkurtesave.....	3
1. Komentë të përgjithshme	4
2. Vlerësimi dhe rezultatet.....	4
3. Gjetjet gjatë misionit.....	4
4. Konkluzionet dhe rekomandimet	5
4.1 Rekomandimet për njësitë përgjegjëse në ASK.....	5
4.2 Rekomandimet për punën e Komitetit për Cilësi	5
5 Misioni i radhës	5
6. Puna në të ardhmen	6
Aneksi 1. Termat e Referencës.....	7
Aneksi 2: Programi.....	10
Aneksi 3. Personat e takuar.....	11
Aneksi 4. Procesverbali i Komitetit për Cilësi, shembull.....	12
Aneksi 5. Përmbledhje e rezultateve të komponentit.....	13

Lista e shkurtesave

KPSE	Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane
KSC	Korniza e Sigurimit të Cilësisë (Eurostat)
GSBPM	Modeli i përgjithshëm i procesit të prodhimit statistikor
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KC	Komiteti për Cilësi
PVV	Pyetësori i vetëvlerësimit
SIDA	Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar
TeR	Termat e Referencës

1. Komente të përgjithshme

Ky raport është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit „Përkrahje për Statistikat”. Ishte misioni i tetë në komponentin e parë të projektit. Detyra kryesore ishte përcjellja e arritjeve të deritanishme në këtë komponent dhe dhënia e rekomandimeve se si të fuqizohet në të ardhmen puna rreth cilësisë në ASK, si dhe mbajtja e një trajnimi mbi Kodin e Praktikës, Kornizën e Sigurimit të Cilësisë dhe vlerësimin profesional.

Konsulentët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e konsulentëve dhe e kanë bërë qëndrimin në Kosovë të këndshëm dhe të paharrueshëm.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së, Statistikave të Danimarkës/Finlandës.

2. Vlerësimi dhe rezultatet

Konsulentët kanë pasur tre takime me Komitetin për Cilësi. Në takimin e parë u diskutuan aktivitetet e zhvilluara që nga misioni i kaluar (mars 2015). Gjatë kësaj kohe u analizuan:

- Rezultatet e anketës së kënaqshmërisë së përdoruesve:
 - Është publikuar një përmbledhje e këtyre rezultateve. Do të bëhet edhe një anketë gjatë një takimi me përdoruesit e statistikave ekonomike.
- Nevojat e stafit për trajnime:
 - Janë mbledhur deri me 17 Prill 2015
 - Deri tani nuk janë përdorur shumë këto informata në dispozicion
- Zgjerimi dhe përdorimi i listës kontrolluese në procesin e anketave?
 - Lista është përdorur në disa anketa por jo në të gjitha
- Përgatitja e mandatit të Komitetit për Cilësi
 - Nuk është zbatuar sepse pritet miratimi nga zyra ligjore e kryeministrisë
- Puna rreth metadatave, rezultatet konkrete
 - Kjo po shkon shumë mire me projektin e SIDA
- Në përgjithësi: Fuqizimi i punës së Komitetit për Cilësi (planifikimi-implementimi-monitorimi-vlerësimi)

Në takimet e tjera me Komitetin për Cilësi u diskutuan (1) rekomandimet për punën e Komitetit për Cilësi dhe (2) koordinimi i sistemit statistikor kombëtar. U bënë edhe tri prezantime për këto.

Gjatë ditës së katërt u mbajt një trajnim mbi Kodin e Praktikës, Kornizën e Sigurimit të Cilësisë dhe vlerësimin profesional.

Dhe në fund, u diskutuan me grupin rezultatet e misionit dhe rekomandimet për të ardhmen. Rekomandimet paraqiten në një pjesë të veçantë të raportit.

3. Gjetjet gjatë misionit

- Në trajnim morën pjesë 15 pjesëmarrës dhe shkoi shumë mirë.

- ASK-ja duhet të plotësojë pyetësoin e vetëvlerësimit lidhur me implementimin e Kodit të Praktikës të Statistikave Evropiane.
- Ka nevojë për këshilla nga ekspertët për plotësimin e pyetësoit. Është rënë dakord që ASK-ja të plotësojë pyetësoin sa më shumë që është e mundur deri më 7 janar 2016 dhe tu dërgojë përgjigjet konsulentëve.
- Është vendosur që me 25-27 Janar 2016 të mbahet një takim me 15 persona nga ASK lidhur me plotësimin e pyetësoit të vetëvlerësimit.
- Është diskutuar me SIDA mungesa e një politike mbi konfidencialitetin dhe është rënë dakord që e njëjta të merret përsipër nga projekti i SIDA pasi ata tashmë kanë disa aktivitete lidhur me sigurinë e të dhënave.
- Politika e diseminimit do të përgatitet me ekspertët e projektit të binjakëzimit kah fundi i projektit.

4. Konkluzionet dhe rekomandimet

4.1 Rekomandimet për njësitë përgjegjëse në ASK

- ASK-ja duhet të mendojë seriozisht edhe për një projekt binjakëzimi.
- Bazuar në nevojat për trajnime të departamenteve të ndryshme, ASK-ja duhet të caktojë prioritetet dhe t'ua paraqesë nevojat edhe donatorëve.
- Disa nga këto nevoja mund të realizohen në kuadër të programit IPA dhe gjithashtu në një projekt tjetër të mundshëm binjakëzimi.

4.2 Rekomandimet për punën e grupit për cilësi

- Duhet të fuqizohet puna e Komitetit për Cilësi.
- Komiteti për Cilësi duhet të ketë rregullat e punës (sekretarin, shpeshësinë e takimeve, programin dhe procesverbalet, shpërndarjen e procesverbalit etj.).
- Komiteti për Cilësi duhet të organizojë dhe koordinojë plotësimin e pyetësoit të vetëvlerësimit për të analizuar të gjitha parimet e Kodit të Praktikës dhe për të identifikuar fushat, ku kërkohet përmirësim, sa më shpejt që është e mundur. Rezultati i kësaj pune do të përbëjë bazën për misionin e ardhshëm në Janar.
- Përcjellja e punës me metadatat, sigurimi i rezultateve konkrete.
- Fuqizimi i mëtejshëm i Komitetit për Cilësi (planifikimi-implementimi-monitorimi-vlerësimi).

5 Misioni i radhës

Misioni i ardhshëm do të mbahet me 25-27 Janar 2016. Gjatë këtij misioni do të ofrohet ndihmë rreth vetëvlerësimit, që do të jetë vazhdimi i punës në përmirësimin e cilësisë dhe përafrimi me Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane. Kjo do të sigurojë një bazë për përgatitjet e një vlerësimi profesional në ASK në të ardhmen.

6. Aktivitetet e ardhshme

Veprimet, që duhet të ndërmerren si përgatitje për misionin e ardhshëm

Veprimi	Afati kohor	Personi/njësia përgjegjëse
Organizimi dhe koordinimi i plotësimit të pyetësorit të vetëvlerësimit	7 Janar 2016	Ramiz / Komiteti për Cilësi
Plotësimi i pyetësorit të vetëvlerësimit	7 Janar 2016	I gjithë stafi përgjegjës
Përgatitja e rregullave të punës për grupin për cilësi	Sa më shpejt që është e mundur	Ramiz / Komiteti për Cilësi
Planifikimi i misionit të ardhshëm	Fundi i vitit 2015	Per

Aneksi 1. Termat e Referencës



EU Twinning Project
KS12 IB ST 01
Support to Statistics

Termat e Referencës:

Komponenti 1: Një sistem Cilësie për Statistikat

Aktiviteti 1.2.1.3: Vazhdim i përkrahjes së punës rreth Cilësisë në ASK

Afatet kohore:

TeR –të gatshëm: 19 Tetor 2015
Fillimi / përfundimi i akt.: 2-6 Nëntor 2015
Raportimi: 13 Nëntor 2015

Rezultati obligativ i komponentit:

Rezultati obligativ 1.2.1.3	Organizimi i punës rreth cilësisë në statistika	<ul style="list-style-type: none"> Raportet mbi misionet, që ofrojnë këshilla operacionale për sigurimin e cilësisë në fushën prodhimit statistikor, të publikuara në faqen e projektit 	<ul style="list-style-type: none"> Raportet tremujore të projektit të binjakëzimit Raportet mbi misionet Udhëzuesit 	<ul style="list-style-type: none"> Përkushtimi dhe disponeshmeri a në të gjitha nivelet e stafit të ASK-së dhe menaxhmentit Komunikimi dhe pjesëmarrja efektive e të gjitha subjekteve relevante Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes misionëve Resurse të mjaftueshme (njerëzore dhe materiale)
------------------------------------	---	--	--	--

Tema / qëllimi i aktivitetit: 1.2.1.3

Ky aktivitet do të jetë vazhdim i diskutimeve se si të organizohet më si miri puna rreth cilësisë. Do të diskutohen veprimet e realizuara që nga misioni i kaluar. Ekspertët do të diskutojnë me ASK-në se si të ngrisin njohuritë në divizionet statistikore, dhe si të organizohet puna e komitetit për cilësi.

Më pas, ekspertët do të mbajnë një trajnim gjysmë ditor mbi Kodin e Praktikës.

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 1.2.1.3:

Raporti mbi misionin për punën rreth cilësisë në ASK.

Rekomandimet për të ardhmen për komitetin për cilësi, pas përfundimit të projektit

Realizimi i trajnimit mbi Kodin e Praktikës

Konkluzionet finale për komponentin 1 – Një sistem cilësie për statistikat

Stafi i ASK-së:**Komiteti për Cilësi:**

1. Ramiz Ulaj, Kryesues i Komitetit për Cilësi, Drejtor i Departamentit të Metodologjisë & TI
2. Ibrahim Rustemi, Drejtor i Departamentit të Planifikimit, Koordinimit dhe Komunikimit
3. Bekim Canolli, Menaxher i Cilësisë
4. Servete Muriqi, Anëtare e Komitetit për Cilësi
5. Xhevrie Fetahu, Anëtare e Komitetit për Cilësi

Trajnimi mbi Kodin e Praktikës

1. Ramiz Ulaj, Drejtor i Departamentit dhe Kryesues i Komitetit për Cilësi
2. Bekim Canolli, Shef i Metodologjisë dhe Menaxher i Cilësisë
3. Arta Salihu Morina, Departamenti për Planifikim Koordinim dhe Komunikim
4. Violeta Gashi, Departamenti i Statistikave Bujqësore
5. Flutura Shosholli, Departamenti i Statistikave Bujqësore
6. Emina Deliu, Departamenti i Statistikave Sociale
7. Sanije Ismaili, Departamenti i Statistikave Sociale
8. Sanije Uka, Departamenti i Statistikave Sociale
9. Naime Rexhepi, Departamenti i Statistikave Sociale
10. Besarta Thaci, Departamenti i Statistikave Sociale
11. Avni Kastrati, Departamenti i Statistikave Sociale
12. Ismail Sahiti, Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare
13. Ibrahim Rustemi, Drejtor i Departamentit për Planifikim Koordinim dhe Komunikim
14. Haki Kurti, Departamenti i Statistikave Bujqësore
15. Ibish Asllani, Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare
16. Sabri Zbergja, Regjistrimi i Popullsisë

Ekspertët e vendëve anëtare:

Z. Lars Thygesen, Drejtor, Shitje dhe Marketing, Statistikat e Danimarkës, lth@dst.dk

Znj. Hilka Vihavainen, ish Drejtoreshe e Pergjithshme, Statistikat e Finlandes, hilkkal.vihavainen@gmail.com

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit:

Z Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj Nora Zogaj, asistente e RTA, zogaj.nora@gmail.com

Historiku

7 misione në kuadër të projektit kanë shënuar progres në fushën e cilësisë:

- është formuar Komiteti për Cilësi
- është emëruar menaxheri i cilësisë
- është mbajtur një takim me përdoruesit
- është realizuar dhe analizuar një anketë mbi kënaqshmërinë e përdoruesve
- është finalizuar Rregullorja për Komitetin e Cilësisë (por akoma nuk është miratuar)
- është finalizuar Deklarata e Cilësisë (por akoma nuk është miratuar)
- është përpiluar një anketë mbi kompetencat e stafit dhe e njëjtja është analizuar

Tani Komiteti për Cilësi duhet të sigurojë që divizionet statistikore implementojnë cilësinë statistikore. Përveç kësaj, duhet të diskutohet se si të organizohet në të ardhmen puna rreth cilësisë në ASK dhe si të organizohet puna e Komitetit për Cilësi.

Aktivitetet, që duhet të ndëmerren si parapërgatitje për misionin:

- Raporti i misionit 1.0.1: Faza I: Zhvillimi i hartës rrugore për implementimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë (Vihavainen & Thygesen)
- Raporti i misionit 1.2.1: Një sistem cilësie për statistikat. Organizimi i punës rreth cilësisë (Thygesen)
- Raporti i misionit 1.2.1.1: Organizimi i punës rreth cilësisë në statistika: Takimi me përdoruesit (Thygesen, Vihavainen, Wulff)
- Raporti i misionit 1.2.1.2: Vazhdim i përkrahjes në punën rreth cilësisë (Thygesen, Vihavainen)

Aktivitetet e pritura janë:

- Rishikimi i punës që nga misioni i kaluar
- Rishikimi i gjendjes aktuale të punës rreth cilësisë
- Diskutimi dhe dakordimi i një plani për implementimin e cilësisë në ASK
- Diskutimi dhe dakordimi i punës së Komitetit për Cilësi
- Mbajtja e një trajnimit mbi Kodin e Praktikës

Do të përgatiten:

- Raporti mbi misionin – sipas modelit
- Një plan i detajuar për aktivitetet e ardhshme në lidhje me cilësinë në ASK

Aneksi 2: Programi

Day	Time	Event
1	10:00-16:00	ASK: Çfarë është arritur që nga misioni i kaluar në Prill 2015 Diskutime rreth përmirësimit të cilësisë Planifikimi i javës
2	10:00-15:30	Takim me projektin e SIDA Vazhdim diskutimi si të implementohet cilësia në ASK ontinued <ul style="list-style-type: none"> • Përgjegjësitë e Komitetit për Cilësi • Përgjegjësitë e departamenteve statistikores: drejtorët, shefat e divizioneve, stafi • Planifikimi dhe organizimi i trajnimit mbi Kodin e Praktikës
3	10:00-12:00 12:30-16:00	Koordinimi i sistemit statistikor kombëtar Ekspertët përgatisin trajnimin mbi Kodin e Praktikës
4	09:00-12:00 13:00-16:00	Trajnim gjysmë ditor Vlerësimi i trajnimit
5	09:00-13:00	Dakordimi rreth rekomandimeve Takim me udhëheqësin e projektit në ASK, udhëheqësin e komponentit dhe RTA Raportimi

Aneksi 3. Personat e takuar

1. Ilir Berisha, Udhëheqës i Projektit në ASK, Drejtor i Departamentit të Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, ilir.t.berisha@rks-gov.net
2. Ramiz Ulaj, Kryesues i Komitetit për Cilësi, Drejtor i Departamentit të Metodologjisë & TI
3. Ibrahim Rrustemi, Drejtor i Departamentit të Planifikimit, Koordinimit dhe Komunikimit
4. Bekim Canolli, Menaxher i Cilësisë
5. Servete Muriqi, Anëtare e Komitetit për Cilësi
6. Besim Mehmeti, Llogaritë Kombëtare, besim.mehmeti@rks-gov.net

Aneksi 4. Shembull i procesverbalit të Komitetit për Cilësi



Agjencia e Statistikave të Kosovës

Minutat e takimit të Komitetit për Cilësi (shembull)

Data xx.xx.xxxx

Të pranishëm: Emrat e pjesëmarrësve

Mungojnë: Emrat e personave, që mungojnë

1.Rregullat e procedurës

U vendos që programi i takimit të shpërndahet 3 ditë përpara.

2.Minutat e takimit paraprak

Minutat janë miratuar.

3.Gjendja rreth plotësimit të pyetësorit të vetëvlerësimit

Anëtarët e Komitetit për Cilësi raportuan gjendjen. U vendos që përgjigjet e para të jenë të gatshme para takimit të radhës.

4.Takimi i radhës

U vendos që takimi i radhës të mbahet më xx.

Minutat u morën nga: emri i personit

Minutat u shpërndanë: tek të gjithë shefat në ASK

Aneksi 5. Rezultatet e përmbledhura të komponentit

Rezultatet e arritura gjatë projektit të binjakëzimit në komponentin e parë janë:

1. ASK-ja ka definuar politikën e cilësisë. Deklarata e cilësisë mund të gjendet në webfaqen e ASK-së.
2. Është krijuar struktura për menaxhimin e cilësisë. Është formuar Komiteti për Cilësi i nivelit të lartë, edhe pse mandati i tij zyrtarisht ende nuk është miratuar. Projekti ka ofruar këshilla praktike se si do të duhej të funksiononte ky Komiteti.
3. Është emëruar Menaxheri për Cilësi, por jo si pozitë me orar të plotë.
4. Janë mbledhur dhe analizuar mangësitë për sa i përket kompetencave të stafit.
5. Janë mbledhur nevojat për trajnime të stafit, nga departamentet statistikore.
6. Janë mbajtur disa trajnime mbi cilësinë:
 - a. Trajnimi mbi cilësinë në statistika dhe zbatimin e standardeve evropiane mbi cilësinë (me 12 pjesëmarrës).
 - b. Dy persona nga ASK kanë marrë pjesë në konferencën e cilësisë në qershor të vitit 2014.
 - c. Janë ofruar këshilla/trajnim specifik për anëtarët e Komitetit për Cilësi, lidhur me: dialogun me përdoruesit, metadatat, anketat mbi kënaqshmërinë e përdoruesve, koordinimin e sistemit statistikor kombëtar etj.
 - d. Trajnimi mbi implementimin e Kodit të Praktikës të Statistikave Evropiane (15 persona morën pjesë).
7. Në tetor të vitit 2014 është organizuar një takim me përdoruesit. Ka pasur 13 përfaqësues të institucioneve dhe ASK-ja paraqiti planet për hapjen e databankës statistikore (e cila përfundimisht u hap në qershor të vitit 2015)
8. Gjatë këtij takimi u realizua edhe një anketë mbi kënaqshmërinë e përdoruesve. Një përmbledhje e rezultateve është publikuar në webfaqen e ASK-së.
9. Është miratuar një listë kontrollese dhe aktualisht përdoret në disa anketa.
10. Ekspertët ndërkombëtarë kanë dhënë disa rekomandime lidhur me komunikimin me përdoruesit.
11. Udhëzuesit për diseminimin dhe konfidencialitetin janë në përgatitje e sipër.

Me qëllim të koordinimit me projektin e SIDA, aktivitetet lidhur me metadatat u anuluan meqenëse janë pjesë edhe e projektit të SIDA. Megjithatë, projekti ka përcjellë zhvillimet edhe në këtë komponent.